




Republika e Kosovës
Republika Kosova - RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës
OpštinaPristina -Municipalityof Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
28.4.2023, e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Begiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Trierë Kasumi-Berisha (LVV), Sami Salihu (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Endrit Gashi (AAK) dhe Sami Boroci (AKR).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkyetar i Komunës, Donjëtë Sahatçiu, nënkyetare e Komunës, Bersant Beka, drejtës i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtës i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florian Dushi, drejtës i Drejtorisë së Inspeksionit, Ilirik Musliu, drejtës i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtës i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtës i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtës i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtës i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përfaqësues të OJQ-ve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Përparim Rama, kryetar, propozoi që në rend dite të futet pika: Propozimvendimi për miratimin e harmonizimit të bllokut "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01 nr. 35-94056, dt. 04.05.2015.

Bahri Gashi kerkoi nga ekzekutivi që të japë ndonjë informatë më të zgjeruar rreth pikës së katërt të rendit të ditës, se për çfarë libri është fjala. Po ashtu, propozoi që katër pikat e fundit të rendit të ditës, të hiqen nga rendi i ditës dhe të na sillen si raporte më të detajuara për mbledhjen e radhës.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Gashi rreth pikës së katërt të rendit të ditës, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Gëzim Sveçla tha se një pikë që e kemi diskutuar në Komitetin për Politikë dhe Financa e që ka të bëjë me subvencionimin e klubeve sportive, për të mos na vënë në pozitë të keqe, nëse nuk e kemi atë material, kisha propozuar që mos ta fusim fare si pikë të rendit të ditës për shkak se si të tillë nuk mund ta votojmë.

Nora Kelmendi kerkoi nga kryetari, të dijë arsyen e sjelljes në Kuvend të pikës së propozuar rreth Planit rregullues "Arbëria 3".

Granit Rugova, drejtor, propozoi që në rend të ditës të futen edhe pikat: Propozimvendimi për subvencionimin e klubin të basketbollit "Prishtina" - meshkuj, klubin e basketbollit "Prishtina" të vajzave, klubin e hendbollit "Prishtina" - meshkuj, klubin e hendbollit "Prishtina" të vajzave, klubin e volejbollit "Prishtina" - meshkuj, klubin e volejbollit "Prishtina" të vajzave dhe klubin e futsallit "Prishtina 01".

Gëzim Mehmeti shprehu pakënaqësi rreth pikave të propozuara rreth subvencionimit të klubeve sportive, duke thënë se është e pamundur që ne t'i lexojmë këto materiale të pakompletuara që tash na sillen në Kuvend.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin kryetarit, z. Përparim Rama.

Kryesuesi konstatoi se më 41 vota për dhe 2 kundër, u miratua propozimi i kryetarit që: "Propozimvendimi për miratimin e harmonizimit të bllokut "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01 nr. 35-94056, dt. 4.5.2015, futet në rend të ditës për diskutim.

Donjeta Dragusha tha se do të ishte mirë që kur të kompletohen këto raporte të ndërmarrjeve lokale, atëherë të raportojnë edhe për pasqyrat financiare.

Arianit Beqiri tha se për hir të diskutimit sa më përbajtjesor, do të ishte mirë që këto pika të shtyhen për diskutim në njëren nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Leutrim Retkoceri tha se ne në Komitetin për Politikë dhe Financa u pajtuam që këto informata të ndërmarrjeve lokale të diskutohen në Kuvend, dhe tanë propozimi për këto pika që të hiqen nga rendi i ditës nuk ka logjikë.

Gëzim Sveçla theksoi se këto informata nuk mjaftojnë, nuk na e shuajnë interesimin dhe përgjegjësinë tonë për ta ditur se çka po ndodh në ndërmarrje publike komunale, në ato ndërmarrje të cilat subvencionohen nga ky Kuvend dhe nga taksat e qytetarëve të Prishtinës. Prandaj, për ta sqaruar keqkuptimin edhe me asamblistët e pozitës, ne nuk jemi kundër informatave të cilat ata i kanë përpiluar, por ne po kërkojmë raporte, prandaj në shenjë reflektimi është mirë që t'i tërhiqni këto nga rendi i ditës dhe të sillen në seancën tjetër, të cilën ju ftoj që ta thirrni sa më shpejt.

Endrit Zabërgja tha se nuk jemi kundër diskutimit as kundër informatave, por jemi për zbatimin e ligjit, andaj duke e konsideruar se aktualisht nuk ekziston klima e nevojshme për të nxjerrë asgjë produktive nga këto informata, i bashkëngjitet qëndrimi të opozitës që këto pikat t'ë largohen nga kjo seancë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Gashi.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 11 kundër dhe 11 abstenime, hiqen nga rendi i ditës pikat:

- Informatë lidhur me reportin tremujor janar - mars 2023, të ndërmarrjes publike "Hortikultura", SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore, SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike "Prishtina Parking", SHA dhe
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike "Pallati i Rinise", SHA.

Nora Kelmendi propozoi që pikat e propozuara nga drejtori i Drejtorisë së Sportit për subvencionim të klubeve sportive, të shtyhen për mbledhjen e radhës, pasi që mungon edhe dokumentacioni finanziar i këtyre klubeve.

Pas një konsulte me drejtorin e Drejtorisë së Sportit, pikat e propozuara për subvencionimin e klubeve sportive hiqen nga rendi i ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 42 vota për u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozimvendimi për miratimin e harmonizimit të bllokut "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.2015;
3. Raporti finanziar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 mars 2023 (TM1);
4. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit "3X3 Prishtina Fiba Challenger";

5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Pro-Arte Institute";
6. Propozimvendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave "Prishtina";
7. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së, nr. 01-020/01-62792/22, dt. 21.03.2022;
8. Propozimvendimi lidhur me Planin komunal për riintegrin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Prishtinës, 2023-2025;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 37 vota për, u miratua ekstraktit i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e harmonizimit të bllokut "D2" në kuadër të Planit Rregullues "Arbëria 3", i miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin 01. Nr. 35-94056 e dt. 04.05.2015.

Gëzim Sveçla tha se ka nevojë për një arsyetim ose spjegim të vogël rrëth këtyre ndryshimeve, besoj tashështë konform asaj që ka kërkuar MAFL-ja, por kërkoi nga drejtoria përkatëse që të na njoftoi rrëth atyre ndryshime që janë bërë.

Lidhur me sugjerimet e dhëna nga z. Sveçla, sqarime shtesë dha Arbër Sadiku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 44 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e harmonizimit të bllokut "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3" i miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin 01 nr. 35-94056, e datës 04.05.2015.

Pika e tretë

Raporti finansiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar 31 - mars 2023 (TM1)

Lidhur me Raportin finansiar buxhetor të Kryeqytetit, për periudhën 1 janar 31 - mars 2023 (TM1), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Rashit Gashi tha se po ta krahasojmë reportin e vtitit të kaluar mund të konstatojmë se të hyrat kanë një rënje rrëth 20%. Të hyrat nga taksa për shfrytëzim, po ti krahasojmë me vitet paraprake janë tmerrsisisht më të ulta rrëth 70 % dhe këtu shihet se është një performancë jo e mirë. Te shpenzimet në paga dhe mëditje kanë pasur një rritje të konsiderueshme në masën prej 13%, e që kjo kategori mendoj se paraqet një problem serioz. Po ashtu realizimi i projekteve në drejtortë komunale është jo i kënaqshëm, kështu që kemi drejtori që në këtë periudhë kohore me zero projekte të realizuara. Gjithashtu detyrimet kontigjente janë në masën jashtëzakonisht të madhe me raportet paraprake, ku 6.3 milion euro janë të evidentuara për detyrime kontigjente e që konsideroj se është tejet shqetësuese.

Jeta Rafuna-Hasani tha se qeverisja e kryetarit Rama ka marrë një kahje shumë dinamike duke bërë planifikime të sakta të projekteve dhe duke u kujdesur që të jetësohen këto projekte. Sot po e diskutojmë reportin e tremujorit të parë të vtitit fiskal dhe shohim në këtë raport trendin pozitiv të hyrave si shkak i rritjes së efikasitetit të Komunës në mbledhjen e të hyrave vetanake. Të hyra tatimore dhe jo tatimore kanë shënuar rritje prej 26.67 %, më shumë se në tre mujorin e vtitit paraprak dhe për këtë e përgëzojmë ekzekutivin. Në raport po ashtu shihet realizimi në vlerë afër 882 mijë euro të investimeve kapitale për periudhën janar - mars me një rritje prej 544 mijë euro nga tre mujori i parë i vtitit të kaluar.

Fatmir Dervishi tha se realizimi i projekteve të planifikuara ndikon në përmirësimin e jetës së qytetareve në shumë sfera, duke filluara në ato të shërbimeve publike, si: uji, mbeturinat, gjelbërimi, trafiku urban, po edhe në arsim, shëndetësi, sport dhe infrastrukturë.

Sipas rapportit të ofruar të hyrat vetanake për tremujorin e parë janë afërsisht 8 milionë, ose 26% më shumë së në tremujorin e vtitit 2022, që është e mirë, mirépo në anën tjetër kemi shpenzime shumë të ulëta të buxhetit, sidomos në ato të investimeve kapitale, që duke e marrë parasysh edhe natyrën e punës së investimeve kapitale, ku kemi planifikim, tenderim, prokurim e ankesa të ndryshme deri diku mundë të justifikohet që këto shpenzime janë të nivelit shumë të ulët.

Bahri Gashi tha se të hyrat vetanake me një rritje prej 26%, është për ta pëlqyer, por kjo rritje është në disproporcione me punën, d.m.th. 2.18% është shpenzuar buxheti e rritja është 26%, andaj kisha sugjeruar që të punohet më shumë, të harxhohen më shumë mjete dhe uroj që pas 6 muajve të jeni më në nivel.

Gëzim Mehmeti theksoi se kur është çështja e rapportimit të buxhetit, është mirë me qenë drejtorët të pranishëm këtu në sallë, ku kishim mundur të kërkojmë prej tyre pyetje - përgjigje, andaj është shqetësuese mungesa e tyre.

Endrit Zabërgja tha se edhe në vitin e kaluar kemi pasur raporte të tillë, kemi uruar që intensiteti i njëjtë të mos vazhdojë deri në fund të vtitit, por fatkeqësisht ka vazhduar.

Qysh mundet me qenë një buxhet transformues për Prishtinën, kur Prishtina sipas institutit GAP, renditet po thuajse e fundit ne efikasitetin e shpenzimeve kapitale.

Konsideroj që kjo logjikë e qeverisjes është më shumë bllokuese sesa transformuese, duke e pasur parasysh që projekte të ndryshme nuk po arrijnë pothuajse asnjëherë të përfundojnë me kohë. Urojmë që në tremujorin e dytë të rritet efikasiteti i punës dhe të mos vendosemi në fund të listës në vitin tjetër krahasuar me komunat e tjera.

Feim Osmani tha se raporti finansiar që u prezantua sot këtu ka të meta edhe tek të hyrat, mirëpo edhe tek shpenzimet, por duke analizuar në hollësi vërehen me lehtë problemet që kanë dalë në realizimin e tij.

Tek të hyrat nga inspeksioni janë realizuar vetëm 20 mijë euro, që i bie 20 %, nga plani i paraparë vjetor. Tek shpenzimet kapitale realizimi është vetëm 2.18%, kjo tregon së nga afër 15 milionë të shpenzuara nga buxheti vjetor i mbi 106 milionëve të planifikuara, vetëm 2% kanë shkuar aty ku qytetari ka më së shumti nevojë.

Gjithashtu, është një pozicion interesant, që vlen të shtrohet pyetja dhe të marrim përgjigje, detyrimet nga Zyra e përfaqësimit juridik, pra janë mbi 100 lëndë që përmbajnë detyrime e që duhet të kompensohen nga buxheti i Komunës, kështu që për këto detyrime kisha kërkuar një përgjigje.

Nora Kelmendi tha se po t'i referohemi këtij raporti, mund të konstatojmë se në disa të hyra kemi trend pozitiv, varësisht nga puna e drejtorive, ndërsa në disa trendi i të hyrave dhe shpenzimeve kapitale ka qenë negativ, gjithmonë duke i krahasuar vitet paraprake. Në këtë raport janë pasqyruar disa të dhëna, e që kanë të bëjnë si p.sh. me qiranë e banesave, dhe kërkoi të dijë se për çfarë qiraje bëhet fjalë këtu. Po ashtu, disa drejtori kanë borxhe të mbetur, të cilat përcillen prej vitit 2022 në vitin 2023, dhe a kanë ndonjë plan që këto drejtori për mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme. Sa i përket realizimit të projekteve edhe në disa drejtori të tjera, me realizim të projekteve nuk qëndrojnë mirë, që tash për tash kemi një trend negativ të investimeve kapitale, mirëpo shpresoj që gjatë muajve në vijim do të ketë një trend pozitiv.

Fiknete Bejta tha se tremujori i parë i viteve është i njëjtë, nuk kalon shifren mbi 3% të realizimit të investimeve kapitale, dhe se të gjithë pajtohemi që janë tre hapa që dëmtojnë këtë proces: hapja e thesarit, që shpesh herë me vendim të Ministrisë së Financave vonohet, gjithashtu edhe procedurat e prokurimit e dëmtojnë këtë proces dhe që varet nga niveli qendror.

Ligjshmëria e bartjeve në vitin e kaluar ka ndodhur vonesa mbi gjashtë mujorin, Qeveria e ka vonuar ligjshmërinë e bartjeve në nivel komunal në vitin 2021 më shumë se gjashtë muaj, ndërsa edhe këtë vit me gjithë këto tensione, tendenza për t'i marrë 28.8 milionë euro po vërehet, që do ta dëmtojë këtë proces. Që të jemi pak më realist dhe ku të na shkojë fjala të bëjmë pak presion në të mirë të interesave të qytetarëve të Prishtinës, ajo çka ka ardhur prej drejtorit të Investimeve Kapitale, ai vetëm e ka kryer punën e tij, ku 99% të projekteve që kanë shkuar në prokurim kanë qenë të projektuara, të planifikuara mirë.

Arianit Beqiri tha se ne të gjithë jemi të interesuar të bisedojmë për investimet kapitale për shkak se ato janë më të dukshme në terren, ku e shohim edhe punën e qeverisë, dhe lidhur me këtë kërkoi të dijë se a ka ndonjë plan për rritjen e të hyrave komunale dhe mendoj se ka rritje 26% në krahasim me vitin e kaluar. Besoj se rritja e të hyrave bëhet konform përmirësimit të cilësisë së përmirësimeve. Nëse flasim edhe për licencimin e ndërtimit ose ndërtimeve pa leje, mbase është ide ose kështu si propozim, ndoshta duhet të përmirësohet se si ofrohen këto shërbime apo të jetë më e digitalizuar, apo të ketë mundësi nëpërmes platformës, ose çfarëdo forme tjeter. Rritja e të hyrave komunale është konform përmirësimit të cilësisë në terren, dhe nëse shërbimet në terren nuk janë aq të mira, mbase edhe kjo është njëra prej arsyeve që mundet të mos ketë rritje të të hyrave.

Rashit Gashi tha se shpenzimet kapitale janë ekzekutuar me një normë jo të kënaqshme, me një vlerë prej 2.18%. Projektet të cilat janë planifikuar gjatë kësaj periudhe

tremujore, janë gjithsej në numra 90 projekte, 16 prej tyre kanë filluar realizimin, d.m.th. vetëm 17%.

Gëzim Sveçla tha se tendencat që çështjen e bartjes së mjeteve të viteve 2021 e tutje me e lidhur me këtë raport nuk qëndron, siç po mundohen ta bëjnë disa asamblistë përfaqjesues të pozitës dhe pa marrë parasysh a ishin transferuar të gjitha mjetet apo vetëm ato të vitit 2022, impakti i tyre në realizimin në TM 1 është zero, që do të thotë se kurrfarë lidhje nuk ka bllokimi i mjeteve, ashtu siç parashihet me Ligjin për buxhet.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë: Krenar Xhaferi, drejtor, Përparim Rama, kryetar, Mimoza Sylejmani, drejtore dhe Arben Kçira, zyrtar nga Zyra ligjore.

Kryesuesi konstatoi se më 13 vota për dhe 1 kundër, u miratua Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar 31 - mars 2023 (TM1).

Pika e katërt

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit "3X3 Prishtina Fiba Challenger".

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Granit Rugova, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit "3X3 Prishtina Fiba Challenger".

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Pro-Arte Institute"

Për këtë pikë të rendit të ditës, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 33 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Pro-Arte Institute".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave "Prishtina".

Lidhur me subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave "Prishtina", në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Granit Rugova, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 32 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave "Prishtina".

Pika e shtatë

Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së, nr. 01-020/01-62792/22, dt.21.03.2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 36 vota për, u miratua Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së, nr. 01-020/01-62792/22, dt.21.03.2022.

Pika e tetë

Propozimvendimi lidhur me Planin komunal për rintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Prishtinës, 2023-2025.

Për këtë Propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Betim Avdullahu, zyrtar nga Zyra e komuniteteve.

Violeta Salihu tha se gjatë hartimit të kësaj strategjie shtetërorë për riintegrim janë përbushur të gjitha kërkesat që dalin nga Programi kombëtarë për zbatimin e MSA-së, si dhe janë përbushur të gjitha kriteret e caktuara nga Udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave. Në bazë të analizës së planit të veprimit shihet planifikimi i aktiviteteve që përcakton përfshirjen e të huajve në jetën sociale, ekonomike, kulturore, duke promovuar ruajtjen e kulturës së tyre, gjuhës, të drejtat dhe liritë e tyre qytetare, si dhe riintegrimin e qëndrueshëm socio- ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit të vazhdueshëm në segmente të caktuara. Plani i veprimit i përshkruan aktivitetet e ndryshme që planifikohen të realizohen nga institucionet lokale, duke u fokusuar në veçanti tek Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Ajo më pas shtoi se, përderisa Plani komunal i veprimit është në harmoni me Strategjinë shtetërorë, ne si grupi i LVV-së e përkrahim, por në të njëjtën kohë mendojmë që duhet të kemi një pasqyrë më të qartë për numrin e personave të riatdhesuar që marrin shërbime në Komunën e Prishtinës.

Ajet Brajshori theksoi se ky plan është i mirëpritur dhe përbën një strategji shumë të qëndrueshme të Komunës së Prishtinës, sidomos për njerëzit të cilët kanë nevojë për riatdhesim dhe trajtim në mënyrën më të mirë për të gjitha rr Ethanat dhe kushtet që i kérkon vetë jeta.

Si grup parlamentar i LDK-së, e përkrahim miratimin e këtij plani dhe strategjinë e zhvillimit për riatdhesimin e të gjithë atyre të cilët duan të jenë banorë të Kryeqytetit të Kosovës.

Bahri Gashi kërkoi të dijë mënyrën se si është zgjedhur ky grup punues.

Lidhur me ngritjen e disa çështjeve dhe sugjerimeve rrëth këtij plani, sqarime të nevojshme dha Betim Abdullahu, zyrtar nga Zyra e komuniteteve.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 33 vota për, u miratua Vendimi për Planin komunal përintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Prishtinës, 2023-2025.

Pika e nëntë

Pyetje dhe përgjigje

Gëzim Sveçla, për kryetarin e Komunës, drejtoren e Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit:

- Në rrugën "Agim Ramadani", mburojat për shtegun e çiklistëve, shiritat për qarkullimin kanë mbetur shumë të ngushtë, andaj mendoj që duhet vepruar dhe gjetur një zgjidhje përtë krijuar dhe zgjeruar hapësirat, në mënyrë që rastet urgjente që i bart automjeti i ndihmës së shpejtë të ketë hapësirë për qarkullim sa më të lehtë, e që mos të ndodhë të kemi ndonjë fatkeqësi që mund të përfundojë edhe me fatalitet,
- Ndërprerjet të cilat janë vendosur në mes të rrugës për kthim të plotë, e që ky orientim ka krijuar tollovi vazhdimesh gjatë gjithë ditës, në drejtimin prej rr. "Agim Ramadani" deri te Komuna, mendoj se edhe në këtë drejtim duhet të bëni një zgjidhje.
- Uji i pijes për Zllatar ka qenë një problem i kamotshëm dhe besoj se duhet të zgjidhet.
- Po ashtu, për ujë dhe kanalizim është problemi në Marec dhe 21 fshatra të asaj zone, të cilat nuk janë të lidhura në ujësjellësin publik, problem që duhet të zgjidhet.
- Është premtuar se me ndryshimin e çmimit të derivateve do të ulet edhe çmimi i startit të taksize, por kjo nuk po ndodhë.
- Pyetja tjetër ka të bëjë me gjendjen nëpër shkolla si pasojë e grevës ose pamundësisë përtë punuar punëtorët teknikë të shkollave.
Ku ka ngecur ky proces, cilat janë veprimet që jeni duke i ndërmarrë që të sigurohet pastërti nëpër shkolla?
- Jemi të vetëdijshëm që në disa shkolla ka pasur intervenime nga Ndërmarrja Publike Banesore, nga punëtorë të kësaj ndërmarrjeje të cilët shkojnë gjatë ditës, dy herë në ditë dhe i mbledhin mbeturinat. Nuk është fjala vetëm për mbeturinat e ngurta të cilat shihen, këtu po flasim edhe përtualet e oborre, prandaj mendoj që duhet të intervenohet para se të bëhet më e madhe.
- Kanë kaluar më se 90 ditë nga përrurimi i punimeve të rrëthrrrotullimit të Arbërisë dhe rrëthrrrotullimit të madh rrugës për Fushë-Kosovë dhe Mitrovicë dhe punët ende nuk kanë përfunduar. Kërkoj të dijë se edhe sa kohë kryhet ky projekt.
- Një kërkesë e cila është drejtuar nga ministrja e Arsimit, znj. Nagavci, e që ka të bëjë me lejet e ndërtimit për çerdhet, e që ende nuk është kompletuar procedura e pajisjes me leje, si dhe ka pasur kërkesë që të ndajmë hapësira ku mund të ndërtohen çerdhet.
- Disa organizata fitimprurëse e shfrytëzojnë hapësirën e bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në lagjen "Dardania", do të thotë e shfrytëzojnë pronën komunale, ndërkohë që krijojnë dhe inkasojnë të hyra.
- Po ashtu, në lidhje me një konkurs që është zhvilluar në bibliotekë, kemi pasur shumë ankesa prej kandidatëve që nuk ka pasur transparencë të mjaftueshme dhe e kanë pasur shumë vështirësi përti i gjetur shpalljet përtë këtë konkurs.

Rashit Gashi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejorisë së Inspeksionit:

- Në lagjen "Përroi i Njelmët", në rrugën afër rrethit "Te Ismeti", rrugë e cila del te "ETC", është një deponi e cila është duke u stërmbrashur me mbeturina të tjera, për të cilën ende nuk ka marrë masa ekzekutivi. Gjithashtu, njëjtë është duke ndodhur edhe me një deponi tjetër e cila gjendet në rrugën "Lidhja e Prizrenit", aty është një gropë e mbushur me mbeturina, por po mbushet edhe me ujë kur po ka reshje shiu e që paraqet rrezik përfshirë fëmijët e asaj lagjeje.
- Kompanitë të cilat ofrojnë shërbime publike, siç janë "KEDS", "Ujësjellësi" etj. dëmet që po i shkaktojnë në infrastrukturë nuk po i kthejnë në gjendjen e mëparshme, si p.sh. punimet në rrugët "Johan V. Hahn", "Jonuz Zejnallahu" dhe rruga "Harmonia". Po ashtu, ka edhe rrugë të tiera nëpër kryeqytet dhe është mirë që të merren masa në këtë drejtim.
- Furnizimi me energji elektrike në disa lagje apo fshatra nuk është i rregullt, është tensioni tepër i ulët dhe do të ishte mirë që Komuna të përdorë mekanizma të vetë që me i detyruar me pasur një furnizim të rregullt dhe tension stabil.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për kryetarin e Komunës:

- Në rrugën "Hydajet Lezha" në lagjen "Kodrën e Trimave", afër fshatit Sinidoll janë 10 familje dhe shtëpi që kanë problem me kanalizim. Para disa viteve kur fshati Sinidoll ka zgjedhur këtë problem të kanalizimit, ato familje nuk janë përfshirë përfshirë t'u zgjidhur ky problem.
- Banorët e lagjes "Sofalia" kërkojnë ndërtimin e një QMF-je, një shkolle fillore dhe një çerdhe publike.

Endrit Zabërgja, për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Drejorisë së Investimeve Kapitale:

- Kryetar, ju keni planifikuar një pjesë të Pallatit të Rinisë përfshirë destinuar përininë e Prishtinës dhe dua ta dijë se cili është vizioni juaj përfshirë këtë qendër, duke e pasur parasysh që e kemi thënë disa herë, se një qendër e tillë është e domosdoshme.
- Sipas disa informacioneve, thuhet se rruga "Jim Xhema" është e kontraktuar me një kompani e cila e ka të ndaluar të jetë konkurrente në tender publik.
- Qytetarët e lagjes "Kalabria" vazhdimiñt kanë kërkesa përfshirë informacion përfshirë planin rregullues të kësaj lagjeje dhe deri ku ka mbërritur procedura përfshirë realizimin e këtij planit?
- Në Lagjen e Muhaxhirëve tash e sa kohë kemi kërkesë përfshirë një çerdhe publike, pasi që numri i banorëve po shkon vazhdimiñt duke u rritur.
A po planifikohet dhe kur mund të presim që të kemi një çerdhe përfshirë lagjes?
- Pika informuese në kryeqytet po përdoren përfshirë afishe, përfshirë lajmërimet, përfshirë shpallje me qira, banesa etj. dhe nuk e dijë se a është duke i menaxhuar apo trajtuar dikush, në mënyrë që ato të duken ashtu dhe ta kryejnë rolin përfshirë cilin janë të thirrur.
- Kryetar, a mund të presim fluks të ri në pastrimin e kryeqytetit apo e kemi të domosdoshme me e pritur tanë një konsulencë të na tregojë se çfarë duhet të bëhet e me vazhduar pastaj me procedurat tjera.

- Kërkesë apo shqetësim i banorëve të lagjes "Tophane" është usurpimi i trotuarit në rrugën "Lidhja e Prizrenit", trotuari që bllokohet nga bizneset aktuale që funksionojnë.

Bahri Gashi, për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Mbikalimi tek Shkolla e Mjekësisë duket tejet i shëmtuar, a keni menduar të bëni diçka me atë mbikalim?
- Në rrugën "B", a është duke u respektuar rregullorja që e parandalon zhurmën e lokaleve, si dhe në pjesët e tjera të qytetit, pasi që banorët ankohen për zhurmën që krijohet nga ato lokale?
- A jeni dakorduar me Qeverinë për ndërtimin e urës në rrugën "A", kush do ta bëjë ndërtimin e saj?
- Pse nesër punojnë shkollat e Prishtinës, e zëvendësojnë Ditën e Pashkëve, mos po bëjmë gabim me komunitetin katolik, me e zëvendësuar Ditën e Pashkëve që është pushuar me një të shtunë?
- Disa ekipe sportive që i ka pasur Prishtina deri në vitet e 90-ta, si p.sh disa boksierë, futbollistë e plot të tjerë, a do kishte qenë mirë që Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Sportit dhe kryetari me e bërë një regjistër të këtyre njerëzve që janë gjallë, e me ua dhënë nga një mirënjojje për kontributin që e kanë dhënë deri në vitet e 90- ta?
Do të ishte mirë që me e pas parasysh këtë pikë dhe me bërë diçka në këtë drejtim.

Violeta Salihu, për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit:

- Këshilli i prindërve të shkollës filllore "Ismail Qemali", në lagjen "Bregu i Diellit", e kanë dërguar një ankesë te Zyra Kombëtare e Auditimit, ku kanë kërkuar një auditim të hollësishëm të gjendjes së mirëmbajtjes nga kompanitë përkatëse, të cilët kanë nënshkruar kontratën dhe është skaduar më 2 prill. Në bazë të auditimit vërehet që nuk është zbatuar as 20% e kushteve të nënshkruara në kontratë në lidhje me higjenën në shkolla, qoftë në përdorimin e pajisjeve higjenike, apo në kushtet dhe orarin e punëtorëve në shkolla. Do të ishte mirë që të merret ndonjë hapë në këtë drejtim përderisa nuk ka shpërthyer një epidemi në shkolla.

Arianit Beqiri, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Banorët afër rrugës "Kristaq Cepa", në lagjen "Emshir", nga shkolla "7 Marsi" deri tek "Klan Kosova", kanë problem të kyçjes në rrugën "Kristaq Cepa" dhe duhet t'i shfrytëzojnë oborret e fqinjëve si mundësi alternative për kyçjen në rrugë.
- Banorët afër rrugës "Arif Gashi", që ndodhet te Bunari i Hajratit, kanë vështirësi në kyçjen në rrugën kryesore, kjo rrugë është në një gjendje jo të mirë dhe ka një gjatësi të madhe.
- Banorët e Gollakut, kryesisht fshatrat Marec dhe Prapashticë, kanë probleme me ndriçim publik dhe mungesë të transportit urban. Po ashtu, rruga që shpie kah varrezat e lagjes në Prapashticë është e myllur për automjete.
- Pjesa dërmuese e lokaleve të gastronomisë nuk kanë shporta të mbeturinave para lokaleve dhe do të ishte mirë me i dhënë si rekomandim Shoqatës së Gastronomëve që të marrin një vendim për ta vendosin një shportë që shërben të paktën për hedhjen e mbeturinave të cigareve.

- Po ashtu, mendoj se prerja e një lisi në qendër të qytetit ka qenë e pakontrolluar, kështu që ndërtimet e mëdha dhe të egra që janë bërë na stimulojnë që të paktën më shumë me i shtuar kujdes gjelbërimit.

Ermal Osmani, për kryetarin e Drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Është një kërkesë prej familjeve që jetojnë me qira, e të cilave Komuna ua paguan gjysmën e qerasë, dhe ata kërkojnë që të kenë pagesa të rregullta mujore nga Komuna, për shkak se ashtu detyrohen edhe nga pronarët e atyre banesave ku ata jetojnë, pasi që Komuna ua paguan në total në fund të vitit e ata kërkojnë që pagesa të bëhet mujore.
- Lokali "Bufo" që shet hamburgerë në rrugën "Rexhep Luci", e shfrytëzon hapësirë publike ndoshta 10 apo 20 fish më të madhe, e për këtë nuk iu bën problem inspeksioni, ndërsa për lokalet tjera ka një tolerancë rreth shfrytëzimit të hapësirave publike. Pse është kjo drejtësi selektive.

Arbnora Berisha, për kryetarin e Komunës:

Kur do të fillojnë punimet për ndërtimin shkollës filllore "Nëna Terezë", pasi që në bazë të banorëve dhe prindërve që nga shtatori nuk ka kurrfarë punimi.

Nora Kelmendi, për kryetarin e Komunës:

- Orari i grumbullimit të mbeturinave a ka ndryshuar apo është akoma orari i njëjtë, pasi që po shohim kamionë edhe jashtë orarit, siç ka qenë më herët, si dhe çështja e orarit përfurnizimin e marketeve, mendoj se tollovia më e madhe bëhet me kombit dhe kamionët që i furnizojnë marketet e vogla dhe të mëdha.
- Këmbimet e pronave komunale të cilat janë kthyer mbrapsht nga MAPL-ja, edhe herën e kaluar ua kam parashtruar të njëjtën pyetje por nuk jeni përgjigjur. Këto këmbime janë kthyer mbrapsht për shkak të disa shkeljeve procedurale, mirëpo asnjëherë nuk kanë ardhur në Kuvend. A e keni ndërmend me i sjellë në Kuvend, apo po prisni që MAPL-ja t'i dërgojë këto në gjykatë.

Granit Geci, për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit:

- Është shqetësim i disa qytetarëve për hapësirat reklamuese që janë në kryeqytet, me theks të veçantë, ekranet të cilat janë shpeshtuar në masë vend e pa vend në shumë hapësira, kështu që sipas informacioneve që kemi, ka qenë në procedurë një rregullore e cila do të bënte rregullimin e këtyre hapësirave reklamuese. Do të doja të dija se deri ku ka mbërritur rregullorja dhe ku ka mbetur të vazhdohet.

Feim Osmani, për kryetarin e Komunës dhe për nënkyetarin e Komunës:

- Pse po vonohet Plani i mobilitetit i "Trafikut Urban" dhe për shkak të shtrenjtimit të biletave të udhëtimit, këtë më së keqi po e pësojnë nxënësit e fshatrave Bardhosh dhe Tenezhdoll.

A ka mundësi me ndërhyrë që së paku me e bërë një riorganizim, me lëshuar një autobus deri në fshatin Tenezhdoll, kështu që kjo çështje po vazhdon të jetë shqetësim bukur i madh i këtyre banorëve.

Radie Hoxhaj, për kryetarin e Komunës:

- Kërkoj nga kryetari që të gjendet mundësia për botimin e 2 apo 3 librave të profesorëshës, znj. Ajmone Dhomë, rrëth fushës muzikore "Libreto". Libreto është forma tekstuale e një këngë, e një kantate, e një opere. Znj. Dhomë ka shkruar shumë libra për moshat parashkollarë, këngë, lodra të ndryshme, si dhe është autore e libretove të veprave të njoitura, operave "Goca e Kaçaniku", "Dasma arbëreshe" dhe kantatës "Urat e vajzave".

Faton Zeka, për kryetarin e Komunës:

- Prej stacionit të autobusëve te Xhamia e Llapit e deri te ish- Banka e Lubjanës nuk ka asnjë stacion autobusi dhe do të ishte mirë që me e bërë një stacion afér Komunës, nga pjesa poshtë Komunës.
- Banorët e fshatit Bardhosh kanë kërkuar një stacion aty te tregu i druve.
- Një kërkesë që e kam parashtruar në mbledhjen e kaluar ka qenë për linjën 7 C, sepse prej kullës së parë të arabëve e deri tek Aleanca nuk është asnjë stacion ku mund të zbresin qytetarët.

Për pyetjet dhe kërkesat e parashtruara nga parafolësit, përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar, Florian Dushi, drejtor, Krenar Xhaferi, drejtor, Mimoza Sylejmani, drejtore, Adelina Sahiti, drejtore dhe Alban Zogaj, nënkyrytar.

Pika dhjetë

Të ndryshme

Feim Osmani tha se sa i përket ndarjes së buxhetit për rrjetin e ujësjellësit përfshirat e Gollakut, konkretisht përfshirat Rimanishtë dhe Sharban, banorët e këtyre fshatrave kanë një shqetësim dhe duan të jenë të informuar se deri ku ka mbërritur procedura rrëth realizimit të këtij projekti, se a ka filluar procedura e tenderimit, apo jemi akoma në atë fazën ku jemi duke e trajtuar problemin se a po shkojmë me shpime nëntokësore apo me e shfrytëzuar rrjetin ekzistues KRU "Prishtina".

Po ashtu, deri ku ka mbërritur procedura përfundim e shkollës në Vranidoll, pasi që mund të rrezikohemi që ta humbim edhe një vit shkollor?

Mbledhja përfundoi në orën 16:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe 13 nga 13